

DEKLARATE PËLQIMI

Duke qënë se në Mars 2010, Kongresi Amerikan ka votuar pro ligjit “Foreign Account Tax Compliance Act – FATCA” për të luftuar evazionin fiskal nga taksapaguesit amerikan që mbajnë llogari jashtë vendit.

Duke qënë se ky ligj prek të gjitha Institucionet Financiare/Banka në mbarë botën dhe ka për qëllim identifikimin e taksapaguesve amerikan që kanë kapital jashtë Shteteve të Bashkuar.

Duke qënë që ligji “Foreign Account Tax Compliance Act, këtu e më poshtë referuar “FATCA”, kërkon nga çdo institucion financiar/bankë të realizojë:

- **Identifikimin** e klientëve që janë taksapagues amerikanë, duke shqyrtuar të gjitha llogaritë e regjistruara në librat kontabël, që shfaqin “indicie/elemente amerikane,, në kuptimin e FATCA-s. Termi “Indicie amerikane,, sipas FATCA-s nënkupton: identifikimin e titullarit të një llogarie bankare si rezident amerikan ose shtetas amerikan, një adresë postare ose rezidencë të këtij shteti (përfshirë adresën postare, adresën e një personi të tretë, adresën e zyrës), vendbanimin në SH.B.A, vendlindjen në SH.B.A, numër telefoni në SH.B.A, një prokurë përfaqësimi ose autorizim lëshuar në favor të një personi me adresë në SH.B.A ose udhër- transfertave periodike të fondeve në një llogari të mbajtur në SH.B.A;
- **Raportimin** pranë Autoritetit Fiskal të SH.B.A “Internal Revenue Service”-“IRS”, mbi bazë vjetore për çdo klient të identifikuar si taksapagues amerikan informacionet që vijnë: Emrin e Mbiemrin e klientit/Gjeneralitet, Adresën, Numrin e Identifikimit Fiskal, Numrin e Llogarisë/Llogarive, Balancën e Llogarisë/Llogarive të tij në një moment të caktuar ose në castin e mbylljes së llogarisë/llogarive nga klienti, mbërritjet ose pagesat e rëndësishme që janë kryer nga llogaria/llogaritë, si dhe çdo informacion shtesë të kërkuar nga IRS.

Duke qënë se Raiffeisen Bank International/shoqëria mëmë e Bankës Raiffeisen Bank Albania sh.a (Banka), si dhe duke patur parasysh që ky ligj është zbatuar gjerësisht në Institucionet Financiare në Europë dhe i imponon Institucionet Financiare/Bankat që ta zbatojë atë, Bankës i lind detyrimi të jetë në përputhje me kërkesat për zbatimin e këtij ligji.

Duke qënë që zbatimi i FATCA imponon përpunim dhe transferim të të dhënave personale të çdo individ që është **Klient** i Bankës, UNE _____, i biri /e bija i/e _____, lindur në _____, më _____._____, shtetas _____, me dokument ID _____, me adresë _____, madhor/e, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, *me cilësinë time si Klient i Bankës, **DEKLAROJ dhe shpreh PËLQIMIN TIM për përpunimin e të dhënave të mia personale nga Banka si më poshtë si vijon:***

1. Deklaroj se i gjithë informacioni dhënë Bankës nga unë është i saktë dhe i vërtetë dhe jam dakort që të dhënat e mia personale të deklaruara prane Bankës në momentin e regjistrimit në Bankë dhe të akumuluar gjatë gjithë marrëdhënies me Bankën, të përpunohen vetëm në kuadër të FATCA dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar.
2. Autorizoj Bankën që për arsye të z dhe zbatimit të detyrimeve të FATCA dhe vlerësimit të statusit tim, të verifikojë saktësinë dhe kompletimin e informacionit të dhënë nga ana ime, të shkëmbejë këtë informacion me Autoritetin Fiskal të SH.B.A-ve “Internal Revenue Service”- “IRS”, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar.
3. Autorizoj në mënyrë të përvokueshme Raiffeisen Bank Sh.a dhe Raiffeisen Invest Sh.a (ne raste investimesh ne fondet e investimit), të përpunojë, transferojë dhe të trajtojë, të gjitha të dhënat e mia personale dhe financiare të deklaruara prej meje, të tashme dhe të ardhme,

tek Autoriteti Fiskal në SH.B.A “Internal Revenue Service”-“IRS”, Shoqëria Mëmë apo çdo palë tjetër që mund të jetë e nevojshme, vetëm për qëllim të realizimit dhe implementimit të FATCA, nëse dhe sa herë që kërkohet. Të dhënat subjekt i këtij përpunimi dhe transmetimi janë: Emri, Mbiemri/Gjeneralitet, Adresa, Numri Identifikimit Fiskal, Numrin i Llogarisë/Llogarive, Balanca e Llogarisë/Llogarive të tij në një moment të caktuar ose në çastin e mbylljes së llogarisë/llogarive nga klienti, mbërritjet ose pagesat e rëndësishme që janë kryer nga llogaria/llogaritë, si dhe çdo informacion shtesë të kërkuar nga IRS.

4. Banka më garanton se janë marrë të gjitha masat për trajtimin e sigurtë të të dhënave personale dhe financiare të mia si Klient, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar.
5. Jam i vetëdijshëm që duhet të paraqes informacionin e kërkuar për FATCA brenda 90 ditëve.
6. Kjo *Deklaratë Pëlqimi* do të jetë në fuqi deri në përfundim të marrëdhënies kontraktuale me Bankën dhe detyrimeve që burojnë në kuadër të FATCA.

Këtë *Deklaratë Pëlqimi* e lëshoj me vullnet të lirë, dhe me qëllim përpunimin e të dhënave personale nga Banka, që lidhen dhe burojnë specifikisht dhe vetëm për qëllimin e realizimit të implementimit të FATCA, në përputhje me legjislacionin përkates:

Me përpunim të dhënash nga Banka në kontekstin e kësaj deklarate bazuar në Ligjin Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, do të kuptojmë “grumbullimin, regjistrimin, ruajtjen, renditjen, përshtatjen, ndreqjen, këshillimin, shfrytëzimin, përdorimin, bllokimin, fshirjen ose shkatërrimin, transmetimin” etj.

Përmbajtja e kësaj Deklarate Pëlqimi është përpiluar në zbatim dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të këtij ligji si dhe Udhëzimin e BSH Nr.31, datë 08.05.2002 “Për Sekretin Bankar”.

E lëshojë këtë Deklaratë duke qënë i mirëinformuar që dispozitat fiskale të SH.B.A-ve janë mjaft komplekse dhe zbatimi i tyre mund të ndryshojë/përshtatet në funksion të rrethanave dhe fakteve të mia si Klient. Jam i ndërgjegjshëm që informacionet në këtë dokument nuk do të interpretohen si këshilla fiskale nga Banka, për çdo pasojë që këto deklarime kanë në situatën time fiskale jam i ndërgjegjshëm që duhet të konsultohem me këshilltarin tim fiskal dhe/ose kontabël.

Emër Mbiemër Firmë

Data: _____

Vendi: _____